



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 513/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionarit të Vendvotimit (VV) në shkollën fillore “Shkëndija” në Hajvali, për shkak të parregullsi gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova Re (AKR).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik AKR, ne te cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në shkollën fillore “Shkëndija” në Hajvali, në Qendrën Votimit (QV) 1927/04 dhe 1927/06, nuk janë numëruar si duhet votat ngase janë humbur 156 vota. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Në raportin e Policisë të datës 14.12.2010, theksohet se në (QV) 1927/04 dhe 1927//06, në shkollën fillore “Shkëndija” në Hjavali, nuk është paraqitur asnjë incident. Në raport po ashtu theksohet se policia ka qëndruar në këtë QV derisa është përcjellur materiali zgjedhor dhe askush nuk e ka njoftuar policinë për ndonjë problem apo incident eventual.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtuesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakun se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë. Ky fakt është konfirmuar edhe prej organeve policore. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 513/2010 më datën 16.12.2010.

